



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2018

**V E N D I M**

**Nr. 209, Datë 17/12/2018**

**PËR**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR**  
**NË MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, MBI "AUDITIMIN**  
**FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË".**  
**për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.08.2018**

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tiranë, me objekt "Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie", për periudhën 01.01.2017 deri në 31.08.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim *opinion të kualifikuar*<sup>2</sup>.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamenti të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi "Auditimin Financiar dhe Përputhshmërie", të ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tiranë, sipas programit të auditimit nr. prot. 1011/1, datë 07.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.08.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A. OPINIONI I AUDITUESIT:

**1. Baza për Opinionin:** Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100<sup>1</sup> dhe 4200<sup>2</sup>) e veprimtarisë së MBZHR, Tiranë.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti MBZHR, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat konsistojnë si më poshtë:- Në raportet e monitorimit të buxhetit mungonte evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi, në kundërshtim me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” pika 95..

- Në raportet të monitorimit të buxhetit, të dhënat faktike të realizimit të buxhetit në MBZHR me situacionet raportuese të thesarit të nxjerra nga Sistemi Informatikë Financiar i Qeverisjes, për periudhën 12 -mujore të vitit 2017 dhe të 8-mujorit 2018, për shpenzimet korente dhe kapitale nuk përputhen plotësisht, pasi nga ministria në raportin e monitorimit nuk janë përfshirë shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”; pika 49.

Nga auditimi i prokurimit publik u konstatuan devijime dhe shmangie nga kuadri ligjor rregullues. Nga auditimi i Sektorit të monitorimit të kontratave, konstatohet se:

- shumica e qiramarrësve, për shkak të konfliktit me pronës nuk e marrin nën administrim të gjithë sipërfaqen e saj, për rrjedhojë dhe zhvillimi i saj nuk kryhet sipas plan bizneseve të paraqitura prej tyre.

- në një pjesë të tyre në rrethin ku ndodhet toka bujqësore nuk janë Depozituar kontratat për rregjistrim në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë Paluajtshme në Rreth.

- nuk janë kryer monitorime për verifikime në vend apo kontrole periodike sipas nenit 6, pika 5 shkronja “a” e cila parashikon se “...Në rast se në përfundim të vitit të tretë konstatohet se Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”, shkronja “b” parashikon se “...në rast se në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, e cila llogaritet në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë..”.

*Nga auditimi i dokumentacionit financiar dhe database të ndërtuar në funksion të arkëtimit të të ardhurave nga qiradhënia e tokave, konstatohen debitorë në arkëtimin e qirave vjetore në vlerën në total 69,998,219 lekë me TVSH (për vitin 2017 në vlerën 31,702,258 lekë, dhe për vitin 2018 në vlerën 38,295, 961 lekë) për vitin 2017 në vlerën 31,702,258 lekë, bashkëlidhur aneksi nr. 1 dhe aneksi nr. 2 sipas subjekteve për çdo vit respektivisht në detyrim total dhe të mbetur për tu arkëtuar.*

### **Opinionit i kualifikuar<sup>2</sup>:**

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4100, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tiranë u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion të kualifikuar<sup>2</sup>.

<sup>1</sup>ISSAI 4100 – Objektivit i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

<sup>2</sup>ISSAI 4100 Kapitulli IV-Raportimi i auditimit/Opinionet e kualifikuara:

Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura ose n.q.s audituesi nuk është në gjendje që të sigurojë evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme janë materiale por jo të përhapura.

## **2. Baza për Opinionin<sup>1</sup>:**

*Auditimi u krye në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit mbështetur në standardet ISSAI 1700<sup>3</sup> dhe ISSAI 1200<sup>4</sup> kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH dhe ligjit nr. 154/2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi administruar janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.*

Bazuar në procedurat analitike dhe teste të detajeve, pas vlerësimit të kontrollit të brendshëm, për të arritur nivelin e kërkuar të sigurisë së arsyeshme, që na lejon të shprehim një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

### **I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.**

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga MBZHR të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale, kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2017.

Grupi i auditimit ka administruar evidenca të mjaftueshme për të krijuar bindje të arsyeshme për të mundësuar dhënien e një opinionit të pavarur. Si përfundim deklaratat financiare janë paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

### **Opinionit i auditimit:**

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të MBZHR në datën 31 dhjetor 2017 për të cilën **japim opinionin të pakualifikuar<sup>5</sup>**.

## **B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PERMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

**1.Gjetja:** Nga auditimi me zgjedhje i kontratave për dhënien me qira të tokave bujqësore në administrim të MBZHR, për vitin 2017, rezultoi se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2013 -2017, ka zhvilluar 58 procedura të dhënies së tokës me qira nga të cilat 50 procedura kanë përfunduar me lidhje kontrate, 8 janë ndërprerë, 48 kontrata janë në fuqi dhe 2 janë anuluar. Dhënia me qira e këtyre tokave nën administrim të saj është kryer nëpërmjet procedurave të parashikuara në VKM nr. 460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” si dhe Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë nr. 6, datë 05.06.2013 “Për kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e përllogaritjes së kriterëve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”.

Për periudhën e auditimit, viti 2017 janë zhvilluar 14 procedura dhe është lidhur kontrata qiradhënie për sipërfaqen prej 370.42 ha tokë , për vitin 2018 me urdhrin nr.559 datë 26.12.2017 të Ministrit, deri në evidentimin e plotë të statusit juridik, pozicionit gjeografik, shkallës së bonitetit të këtyre tokave këto procedura janë pezulluar dhe nuk është zhvilluar dhe lidhur kontratë për asnjë sipërfaqe toke.

<sup>3</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>4</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

<sup>5</sup> Një opinion i pakualifikuar jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

Njësia e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Bujqësisë ,në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 484 prot, datë 09.11.2017,ka kryer një mision auditimi të kombinuar (përputhshmërie dhe financiar) për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2017, me objekt ligjshmërinë e procedurave dhe praktikave për dhënien me qira të tokës bujqësore pasuri shtetërore dhe monitorimin e kontratave të lidhura..” si dhe auditimi financiar ka mbuluar periudhën e auditimit nga viti 2013-Prill 2018, në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 “Për Organizimin Dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 16, pika 2 “Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij, dhe pa cenuar të drejtën për të kryer vetë auditimet, Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të përdorë gjetjet e auditimeve të kryera nga organe të tjera audituese.” nga ana e grupit të auditimit u konsiderua e ezauruar auditimi i proceduarve konkurruese në tërësinë e tyre.

Nisur nga ky fakt, fokusi i auditimit u përqendrua në sistemin e administrimit të tyre dhe monitorimit të kontratave për tokat e dhëna me qera, ku pavarësisht përpjekjeve të bëra nga Ministria për përmirësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Auditimi i mëparshëm i KLSH konstatohet se ka aspekte të pa mbuluara mirë nga korniza ligjore që rregullon këtë proces.

Nga ana e MBZHR-s, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH, janë marrë iniciativat për përmirësimet ligjore në përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit kështu :

- është miratuar VKM nr. 373, datë 20.06.2018, i cili shfuqizoi VKM nr. 460, datë 22.05.2013 dhe Udhëzimi i MBZHR nr. 12, datë 30.07.2018, në zbatim të VKM nr. 373, datë 20.06.2018.

Por konstatohet se : në Kreun IV “*Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*”.

Në Pikën 1 të këtij Kreu, përcaktohet se “*Dhënia me qira e tokave bujqësore në pronësi të shtetit realizohet nëpërmjet procedurës së ankandit*”, përcaktimi i procedurës me ankand nuk është në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën e administrimit të tokave, për faktin se nëpërmjet ankandit shitet prona dhe kjo nuk është e legjitimuar me vendimmarrje tjetër të KM, gjithashtu nëse do ti referohemi ankandit si procedurë, vetë ky proces pra ankandi rregullohet me bazë ligjore tjetër, Ligji për Ankandin Publik dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në pikën 3 të po këtij Kreu, në lidhje me kërkesat që duhet të paraqesë subjekti duhet të moderohet sasia e dokumentave që do të paraqiten nga subjekti, pasi vetë Ministria ka akses nëpërmjet portalit e-albania të verifikojë të dhënat e subjektit nëpërmjet një vetëdeklarim dhe nuk është e nevojshme të paraqesë një sasi dokumentash të cilat shkurtojnë kohë dhe kosto të panevojshme për palët në proces.

Në pikën 9 të kreut 4 kjo është e reflektuar, por e njëjta situatë duhet të jetë dhe në këtë fazë të procedurës.

Në pikën 4 të po këtij Kreu , është përcaktuar afati për 5 (pesë) ditë i lënë që subjektet të plotësojnë mangësitë e dokumentacionit të dorëzuar, ky afat është tejet i shkurtër, dhe humbet të drejtën e kualifikimit si konkurrenës në procedurë, pasi rimarrja e dokumenteve në ZVRPP dhe DAMT, Këshilli i Qarkut kërkon një afat më të gjatë, të përcaktuar nga këto institucione.

Në Kreun V “*Përcaktimi i vlerës vjetore të qiradhënies së tokave bujqësore në pronësi të shtetit*”, Pika 2, nuk saktësohet, kush është struktura përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së qirasë vjetore të tokës bujqësore që do të jepet me qira.

Gjithashtu në shtojcën A Kontrata Tip, konstatohet se ka akoma nevojë për saktësi në afatin e parashikuar për dorëzimin e tokës së trajtuar me qira prej 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, pasi ky afat është i shkurtër,

Në nenin 3 “*Të drejtat dhe Detyrimet e Qiradhënësit*” , në pikën 2 përcaktohet se Qiradhënësi ka të drejtë : të zgjidhë pjesërisht apo plotësisht kontratën e qerasë. Në lidhje me këtë nen konstatohet se nuk është e saktësuar se në cilat raste “zgjidhet pjesërisht” dhe çfarë nënkupton si nocion në terma juridik pasi kontrata zgjidhet ose lihet në fuqi ose ndryshon me amendime me shkrim.

Në nenin 5 Garancia /Sigurimi i Kontratës, pika 1 përcakton se sigurimi i kontratës është në formën e një garancie bankare ose sigurimi të lëshuar nga shoqëritë e sigurimit. Përcaktimi “sigurimi në kompani sigurimi” nuk përputhet me formatin e Aneksi 1 i miratuar për këtë qëllim, citon që sigurimi do të behët nëpërmjet bankës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 74-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **1.1. Rekomandimi:**

- MBZHR si Autoriteti qiradhënës për dhënien me qira të tokave bujqësore, në pronësi të shtetit, ti propozojë Këshillit të Ministrave, amendime të VKM-s nr. 373, datë 20.06.2018, i cili shfuqizoi VKM nr. 460, datë 22.05.2013 në të cilët të reflektohen të gjitha mangësitë e theksuara më sipër.

- Për çdo vit MBZHR të hartojë listën e sipërfaqeve/parcelave që do të jepen me qira, vendodhjen si dhe strategjinë e zhvillimit rajonal të zonës në të cilën ndodhen këto toka, e gjithë kjo nëpërmjet një procesi të formatizuar qartë dhe në fokusin e një transparence të plotë, për të gjitha palët e interesuara, ku vëmendje të posaçme duhet t'i jepet pretendimeve të ish-pronarëve, përpara hapjes së procedurave të qiradhënies.

**Menjëherë**

## **C. MASA ORGANIZATIVE.**

### **1. Gjetja:** *Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural rezultoi se;*

Toka bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural, gjithsej 19 055.35 ha me VKM nr. 45, datë 29.01.2014 **sipërfaqe 18.076 ha**, me VKM nr. 995, datë 9.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **926.55 ha**, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 4.4.2012, nr. 417, datë 8.6.2011 dhe nr. 534, datë 1.5.2008”, **sipërfaqe 926.55 ha**, me VKM nr. 142, datë 24.02.2016 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të MB, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër”, **sipërfaqe 31.4 ha** si dhe me VKM nr. 1103, datë 28.12.2015 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të sipërfaqes së tokës bujqësore 21.4 ha, zona kadastrale 1323, fshati Buronjë, Delvinë, dhe për një shtesë në vendimin nr. 820, datë 13.10.2010, të K.M “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi MBUMK”, **sipërfaqe 21.4 ha**.

Lista e këtyre tokave bujqësore të përcaktuara për qiradhënie sipas VKM –ve të mësipërme, është publikuar në faqen e ASIG dhe të MBZHR [geoportal.asig.gov.al](http://geoportal.asig.gov.al). por nuk rezulton të jenë të shoqëruara me referencë të karakteristikave të sipërfaqeve të ofruara, me të njëjtat kritere të zonave, vendndodhjen e tokave objekt qiradhënie e aq më shumë për cilësitë dhe përshtatshmërinë e tyre në lidhje me një ose disa aktivitete bujqësore të caktuara, pasi transparenca e munguar ka sjellë garë të kufizuar për projektet e zhvilluara.

Pavarësisht rekomandimit të KLSH-s në auditimet e mëparshme, nga ana MBZHR nuk ka një strategji konkrete të zhvillimit të tokave që administrohen prej saj, kjo Ministri nuk ka një plan zhvillimi sektorial bujqësor sipas karakteristikave bujqësore zonale, duke shpallur këtë plan zhvillimi si pjesë të programit të sajë nëpërmjet thirrjeve publike, për shprehje interesi në mënyrë transparente, bazuar në parimin e transparencës dhe barazinë për çdo investitor dhe palë të interesuar për tokat që gjykon se duhen rivitalizuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 74-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **1.1.Rekomandimi:**

MBZHR të hartojë një Strategji konkrete të zhvillimit të tokave që administrohen prej saj , të hartojë dhe bëjë publik një plan zhvillimi sektorial bujqësor sipas zonave, duke e bërë transparent procesin e zhvillimit të tyre duke mos cenuar parimet e transparencës dhe barazisë për çdo investitor dhe palë të interesuar.

**Menjëherë**

**2. Gjetja:** Nga auditimi i procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural rezultoi se;

Shumica e qiramarrësve, për shkak të konfliktit me pretendentë të pronës nuk e marrin nën administrim të gjithë sipërfaqen e saj, për rrjedhojë dhe zhvillimi i saj nuk kryhet sipas plan bizneseve të paraqitura prej tyre.

Në një pjesë të kontratave, në rrethin ku ndodhet toka bujqësore nuk janë depozituar për regjistrim në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë Paluajtshme në Rreth.

Nuk janë kryer monitorime për verifikime në vend apo kontrolle periodike dhe të aplikojë penalitete sipas nenit 6, pika 5 shkronja “a” e Kontratës e cila parashikon se “...Në rast se në përfundim të vitit të tretë konstatohet se, Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”, shkronja “b” parashikon se “...në rast se në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, e cila llogaritet në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 74-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **2.1.Rekomandimi:**

- Në çdo rast, të procedohet, së pari, me verifikimet e pretendimeve të ish-pronarëve, përpara dhënies së tokave me qira që administrojnë Ministria, duke respektuar të drejtën e pronës, për pronarët e ligjshëm. Për tokat të cilat ka pretendime të ish-pronarëve të tyre, në asnjë rast, mos të japi këto toka me qira, pa u zgjidhur më parë konflikti ligjor, duke eliminuar kështu kostot shtese, financiare dhe sociale.

- MBZHR të kryejë monitorime dhe verifikime në vend apo kontrolle periodike dhe të aplikojë penalitete sipas nenit 6, pika 5 shkronja “a” e Kontratës e cila parashikon se “...Në rast se në përfundim të vitit të tretë konstatohet se Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% të investimeve kapitale të parashikuara, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë”, shkronja “b” parashikon se “...në rast se në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe, e cila llogaritet në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë..”.

### **Vijimësi**

**3. Gjetja:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së lëvizjes së fondeve (formati nr. 8), në bilancin e konsoliduar për MBZHR konstatohet se, llogaria 1013 “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së”, e cila merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundër-parti kreditin e llogarisë 209 e 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata”, nga ana e institucioni efekti negativ i llogarisë 209 e 219, për vitin 2017 në vlerën 75,470 mijë lekë është regjistruar në debi të llogarisë 1013, shumë e cila duhet të ishte regjistruar në kredi të llogarisë 1013. Mosparaqitja e saktë e amortizimit në pasqyrën e lëvizjes së fondeve ka çuar në denatyrimin e fondeve bazë të paraqitur në pasqyrën nr. 2 “Pasivi i bilancit”.

Gjithashtu u konstatua se Llogaria 1011, “Shtesa të fondit bazë” e cila është kredituar për shumën e aktiveve të blera apo të krijuara në njësinë e qeverisjes së përgjithshme (për aktivet e marra në dorëzim), mbetjen kreditore të llogarisë 116, “Të ardhura nga shitja e AAGJ-së, si dhe ndikimin pozitiv të ndryshimit të gjendjeve të inventarit në fund të vitit ushtrimor, në total për shumën 3,170,204 mijë lekë, por vlera e paraqitur nga institucioni është në shumën prej 3,870,903 mijë lekë, me një diferencë më shumë në vlerën 701,438 mijë lekë e paargumentuar se çfarë përfaqëson kjo vlerë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **3.1. Rekomandimi:**

Drejtoria e buxhetit në MBZHR të marri masa të menjëhershme, për të sistemuar zërat e paraqitur në pasqyrën e lëvizjes së fondeve (formati nr. 8), argumentet përkatëse, si dhe reflektimin e ndryshimit të “Fondit bazë” në pasivin e bilancit (formati nr. 2).

### **Menjëherë**

**4. Gjetja:** Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilanci) përmbledhëse për të gjithë njësitë vartëse, në fund të vitit 2017, rezultoi se gjendja debitorë (klasa 4) paraqitet në vlerën **2,433,193 mijë** lekë, për të cilat nuk është bërë një ndarje e tyre se, sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa prej tyre kanë një vjetërsi mbi 10 vjet, sa nuk janë likuiduar apo arkëtuar për faj të strukturave që duhet të merren me arkëtimin e tyre. Mungesa e analizave të duhura rreth të arkëtueshmeve ndikon në besueshmërinë e vlerës së tyre. Gjithashtu për vlerat mbi një vit drejtimi nuk ka bërë zhvlerësimin për këto llogari të arkëtueshme. Detyrimet e klientëve janë kërkesa afatshkurta dhe nëse nuk i mbledh subjekti, atëherë parimi i vijimësisë (qëndrueshmërisë) vihet në pikëpyetje.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** MBZHR të marri masa, duke krijuar grup pune të veçantë me përfaqësues të fushës së financave dhe fushës juridike për analizimin e hollësishëm të debitorëve. Të bashkëpunohet me njësitë shpenzuese, për gjetjen e saktë të të dhënave të debitorëve fizik (ish-punonjës) dhe të subjekteve fizik e juridik. Drejtuesit përkatës duhet të sigurojë iniciimin e një procesi rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për arkëtimin e tyre, si dhe të propozojë masa konkrete, duke mos e përjashtuar masat administrative dhe të tjera nëse është e nevojshme.

## Menjëherë

### **4.2. Rekomandimi:**

Të dërgohen shkresa zyrtare për arkëtimin e detyrimeve, për debitor që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, ti propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre.

### **4.3. Rekomandimi:**

Për subjektet private debitore të dërgohen shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të njoftuar për detyrimet që ato kanë ndër vite ndaj Ministrisë së Bujqësisë dhe të merren hapat bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, për të mundësuar arkëtimin e këtyre detyrimeve.

## Në vijimësi

**5. Gjetje:** Nga auditimi i inventarizimit të aktiveve të realizuar sipas urdhrit të Ministrit nr. 386, datë 12.09.2017, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve dhe vlerësimin e tyre, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15 pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74 dhe pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” u konstatua se, komisioni i inventarizimit në procesverbalin e mbajtur për gjendjen e aktiveve nuk ka bërë një ndarje të tyre sipas zërave: vlera total për pajisje informatike, vlera total për vegla pune, mobilieri e pajisje zyre, kaldaja, etj por i ka grupuar në total në dy zëra “inventar ekonomik” dhe “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **5.1. Rekomandimi:**

Nga Drejtoria e Financës të merren masa, për të bërë ndarjen e aktiveve sipas zërave nga inventarizimi, me qëllim verifikimin e gjendjes reale të tyre, si dhe për të verifikuar më lehtësisht diferencat e gjendjes fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet sipas këtyre zërave.

## Në vijimësi

**6. Gjetje:** Nga auditimi i pasqyrave financiare në Ministrinë a Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u konstatua se, në Llogarinë 218 “Inventar ekonomik” janë vlerësuar për dalje jashtë përdorimi dhe asgjësim disa aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në vlerën 20,306,511 lekë, që përputhen me vlerën kontabël fillestare të regjistruar në kontabilitet. Për këto aktive, amortizimi i akumuluar ndër vite është në shumën prej 18,724,830 lekë, ndërsa shuma e llogaritur dhe e zbritur si amortizimi i

akumuluar ndër vite për to është pasqyruar në shumën 20,306,511 lekë, duke bërë që vlera e llogarisë 219 e pasqyruar në pasqyrat financiare të jetë më e ulët për vlerën 1,581,681 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **6.1. Rekomandimi:**

Nga Drejtoria e Financës, të merren masa të menjëhershme për sistemimin e amortizimit të akumuluar të aktiveve (llog. 219), për vlerën 1,581,681 lekë, si dhe sistemimin dhe reflektimin e vlerave në llogarinë respektive, duke rregulluar pasaktësi jo materiale në pasqyrat financiare

**Menjëherë**

**7. Gjetje:** Nga auditimi i aktiveve të regjistruar në kontabilitet ka rezultuar se, vlera e mbetur e disa prej tyre, pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, rezulton të jetë zero ose me vlera të papërfillshme, pavarësisht se aktivi është në përdorim dhe në gjendje pune. Nga Ministria nuk është bërë vlerësim i jetës së dobishme të aktiveve sikundër kërkohet në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **7.1. Rekomandimi:**

Të ngrihet një komision me ekspertë të fushave, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen, duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje:** Nga auditimi i raportit të monitorimit të buxhetit u konstatua se mungonte evidentimi dhe trajtimi i detyrimeve të prapambetura si ato të trashëguara ashtu edhe ato të krijuara rishtazi, në kundërshtim me Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018” pika 95.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **8.1 Rekomandimi:**

Të gjitha programet e MBZHR gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike të cilat përpunohen nga Drejtoria e Buxhetit dhe dorëzohen në Ministrinë e Financës, duhet të trajtojnë detyrimet e institucionit, të japin argumenta në lidhje me krijimin e tyre si dhe masat që parashikohet të merren për likuidimin e tyre.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje:** Nga auditimi i raportit të monitorimit të buxhetit u konstatua se të dhënat faktike të realizimit të buxhetit në MBZHR me situacionet raportuese të thesarit të nxjerra nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisjes, për periudhën 12 -muajore të vitit 2017 dhe të 8-mujorit 2018, për shpenzimet korente dhe kapitale nuk përputhen plotësisht, pasi nga Ministria në raportin e monitorimit nuk janë përfshirë shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”; pika 49.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 32-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **9.1. Rekomandimi:**

Të gjitha programet e MBZHR gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike të cilat përpunohen nga Drejtoria e Buxhetit, duhet të përfshijnë shpenzimet e realizuara nga të ardhurat jashtë planit limit, të shoqëruara me shpjegimet përkatëse lidhur me përdorimin e këtyre të ardhurave.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje:** Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për blerje gomash, mallra konsumi, printim zarfi etj, si dhe fletë-hyrjeve për këto mallra në magazinë, u konstatua se mungon relacioni nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave, për të verifikuar nëse specifikat e



mallit/shërbimit të marrë në dorëzim jenë apo jonë përputhje me kriteret e parashikuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” pika 42-50.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 48-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **10.1. Rekomandimi:**

Të merren masa, që për çdo marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim, i cili duhet të përpilojë procesverbalin nëse mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

**Në vijimësi**

**11.Gjetje:** Nga auditimi i urdhër shpenzimeve, për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes së institucionit, u konstatua se grupi i marrjes në dorëzim të situacionit nga subjekti që ka realizuar shërbimin nuk ka bërë një ndarje të pjesëve të këmbimit që regjistrohet si rritje e vlerës së aktivitetit dhe të vlerës së shërbimit që regjistrohet si shpenzim korentë i periudhës, po e gjithë vlera është regjistruar në kontabilitet si shpenzim mirëmbajtje, duke mos u përmbajtur as kontratës së lidhur midis palëve, ku është cilësuar se brenda kësaj vlerë ka shërbim dhe pjesë këmbimi. Madje dhe në udhëzimin e dalë nga Ministria e Financës me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” citon se përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve kanë një kosto të mëposhme që i shtohet koston fillestare të AAGJM-së.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 48-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **11.1.Rekomandimi:**

Komisioni i ngritur nga nëpunësi autorizues për marrjen në dorëzim dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës, për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes të marrë masat që për çdo situacion të marrë në dorëzim dhe pas verifikimit fizik të shërbimit, të mundësojë një ndarje të vlerës së shërbimit nga vlera e pajisjeve, ashtu siç është cilësuar dhe në kontratën e lidhur midis palëve.

**Në vijimësi**

**12.Gjetje:** Nga auditimi i dokumentacionit të transferimeve kapitale të mjeteve të transportit rezultoi se nuk ka të bashkëngjitur autorizimin e personit që ngarkohet për tërheqjen e mjetit nga institucioni, sikundër kërkohet në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Gjithashtu nga shqyrtimi i fletë hyrjes nr. 9, datë 25.05.2017, ku Ministria ka përfutur një mjet transporti nga projekti GIZ rezultoi se vlera e mjetit në kontabilitet është regjistruar 1 lekë, duke denaturuar vlerën reale të llogarisë 215 “ Mjete Transporti”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 48-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **12.1. Rekomandimi:**

Nëpunësi autorizues duhet të marrë masat për të ngritur një komision me ekspertë të fushave për të bërë vlerësimin e mjeti të transferuar nga Projekti GIZ, duke u mbështetur në çmimet e tregut, pasi është përgjegjës për monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë.

**Menjëherë**

**13. Gjetje:** Nga auditimi i prokurimeve rezultoi se në pikën 2.3 Kapaciteti teknik të Dokumentet e Tenderit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kafshë të llojit gjedh për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatosa nodulare e gjedhit, i ndarë në Lote”, me fond limit Loti I “Blerje kafshë të llojit gjedhë për zonat kodrinore malore” në vlerën 191,103,096 lekë pa tvsh dhe Loti II “Blerje kafshë të llojit gjedhë për zonat ulëta fushore” në vlerën 51,320,000 lekë pa tvsh realizuar në vitin 2017, njësia e prokurimit ka kërkuar dhe vendosur që ofertuesi të paraqes një deklaratë “..... që do dorëzojë mallin pranë Drejtorive të Bujqësive në Qarqe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor”, por pa sqaruar se cilat janë kërkesat specifike, për strehimin e gjesë së gjallë në ambjentet të përshtatshme deri sa të realizohej shpërndarja e tyre tek fermerët të cilët kanë

humbur gjënë e gjallë, në përputhje kjo me dokumentat shoqeruese të përcaktuara në VKM nr.408, datë 08.05.2013 “Për shpërblimin për kafshët e eliminuara” i ndryshuar me VKM nr.945, datë 28.12.2016. Veprim ky në kundërshtim me VKM e sipërcituar dhe me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 (specifikimet teknike).

**b. Gjetje:** Monitorimet e kontratave të furnizimit si për Lotin e I dhe për Lotin e II si dhe dokumentimi i pagesave për furnizuesin, nuk janë bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar, pasi mungon ekzistenca e Komisionit të Mbikëqyrjes së kontratës, për të dokumentuar aktivitetin e dëmshtëpërblimit të gjedhit të gjallë. AK është bazuar vetëm në dy procesverbalet të marrjes në dorëzim nga MBZHR dhe procesverbalit të dorëzimit të gjedhit nga MBZHR në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë dhe faturat tatimore të shitjes të lëshuara nga operatori fitues “N F” shpk (NAFA) me ofertë ekonomike në vlerën prej 190,836,000 lekë pa tvsh për Loti I dhe për Loti II lëshuara nga operatori fitues “N F” shpk (NAFA) me ofertë ekonomike në vlerën prej 51,320,000 lekë pa TVSH . Por, në zbatim të VKM nr.408, datë 08.05.2013 “Për shpërblimin për kafshët e eliminuara” i ndryshuar, në dosjen fizike të administruar nga AK (sektori i prokurimeve dhe sektori i financës) nuk ndodhet asnjë relacion përfundimtar mbi shpërndarjen tek përfituesit, për të vërtetuar numri e saktë të fermerëve përfitues nëpër qarqe të ndryshme të vendit. Po kështu, pagesat e bëra për operatorin fitues “N F” shpk (NAFA), me disa Urdhër shpenzime, konkretisht me nr: 184,186,187,188, 206,209 dhe 216 të muajit qershor 2017 dhe nr. 236 dhe 254 të muajit korrit 2017, nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin ligjor dhe financiar, për dorëzimin e gjesë së gjallë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, si dhe nuk janë të shoqëruara me listat emërore të fermerëve përfitues. Këto veprime bie në kundërshtim me, Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me neni 77, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **13. 1. Rekomandimi :**

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ngrihet grup pune për të kryer inspektimin e dokumentacionit vërtetues ligjor dhe financiar, pranë Drejtorive të Bujqësisë në qarqet përfitues për dëmshtëpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga *dermatoza nodulare e gjedhit për vitin 2017* , me qëllim që të bëhet e mundur pasqyrimi me transparencë, efektivitet, efencë dhe ekonomicitet të fondeve publike të shpenzuar në këtë procedurë prokurues.

**Menjëherë**

**14. Gjetje:** Procedura prokurimit me objekt “Shpenzime mbrojtje e ullishte në bllok nga miza e ullirit në zonat prioritare të prodhimit, qarqet Elbasan, Fier, Vlorë, Tiranë, Lezhë dhe Berat, me fond limit në vlerën 111,138,682 lekë pa tvsh me “procedurë e hapur”, të zhvilluar në vitin 2017 sipas Urdhër prokurimi nr. 247, datë 06.06.2017 është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës. Konkretisht, në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, BOE, “L” shpk & D M (Person Fizik) & F M (Person Fizik). Por, KVO-ja me të drejtë e ka skualifikuar këtë BOE, sepse sipas Kontratës së bashkëpunimit me nr. 865 datë 29.06.2017, këto dy operatorët ekonomikë, kanë përcaktuar pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi, vetëm për përqindjen e pjesëmarrjes së shërbimit dhe nuk kanë përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të marrin përsipër të realizojnë.

Kjo procedurë është zhvilluar përsëri sipas Urdhëri Prokurimit nr. 364, datë 23.08.2017 me fond limit 168,547,182 lekë pa tvsh , por këtë herë “Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Mirëpo u konstatua se, *AK nuk e ka të argumentuar dhe të arsyetuar përzgjedhjen e kësaj procedure sipas kërkesave të nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe me nenin 36 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Po kështu, procedura e dytë “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” është zhvilluar me fond limit me vlerë më të lartë se procedura e parë, konkretisht nga 111,138,682 lekë pa tvsh që ishte në procedurën e anuluar është rritur në vlerën 168,547,182 lekë pa tvsh, pra

57,408,500 lekë pa tvsh më tepër. Shtimi i fondit limit sipas Memo datë 21.08.2017 drejtuar Ministrit nga sektori i prokurimeve dhe ish-sekretari i përgjithshëm, është bërë me këtë argumentin se është shtuar numri i qarqeve të prekura (pra sipërfaqet), ndërsa përcaktimi i procedurës me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është realizuar në kundërshtim me neni 36, pika 2/a, të VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sepse :

Së pari në fillim viti AK (MBZHR) përgatit regjistrin e parashikimeve për procedurat tenderuese, në bazë të kërkesave nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, nisur nga fakti se insekti “miza e ullirit” është evident ku zhvillohet kokrra e ullirit për çdo vit;

Së dyti në bazë të ligjit nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve” i ndryshuar, neni 13, ka parashikuar që në buxhetin vjetor të ministrisë të planifikohen “fonde të veçanta për mbrojtjen e bimëve”, këtij fakti i referohet dhe Urdhri i Ministrit nr. 113, datë 28.03.2017 “Për caktimin e parazitëve të veçantë në bujqësi për vitin 2017”:

Së treti, me shkresë nr. 3606/2 prot, datë 02.05.2017, ku i është kërkuar Ministrisë së Financave, transferimi i këtij fondi nga artikulli 606 në artikullin 602, me arsyetimin që ky fond do të përdoret për realizimin e shërbimit “Mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit;

Së katërti, nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka startuar procedura e prokurimit me objekt “Mbrojtja e ullishtave nga dëmtimi i mizës së ullirit në bllok dhe sipas zonave prioritare të prodhimit”, por nuk ka përfunduar (përgjatë auditimit nuk është paraqitur asnjë arsyetim për mos realizimin e saj).

Për sa më sipër, del qartë se, përzgjedhja e procedurës me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” nga AK me arsyetimin e krijimit të emergjencës nuk është e argumentuar dhe e justifikuar në përputhje me kërkesat e bazës ligjore të sipërcituara. Në kushtet e anulimit të tenderit të parë, AK duhet të nxirrte arsyet e anulimit dhe nëse mungesa e konkurrencës kishte ardhur për gabime në hartimin e DT, pra për faj të vetë AK, duhet të nxirreshin përgjegjësit përkatëse, të korrigjoheshin DT dhe të filloheshin menjëherë përsëri procedurën e tenderit të hapur. Dhe në raste të anulimit të procedurës së dytë për shkaqe objektive, pra të mungesës së konkurrencës atëherë duhet të zhvillonte procedurën e trete me “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”.

Gjithashtu, në procedurën me negociim janë ftuar të marrin pjesë tre operatore dhe ka marrë pjesë vetëm 1 (një) bashkim operatorësh “G G”shpk & “A I”shpk me oferte në vlerën 167,987,180 lekë pa tvsh, i cili është shpallur fitues. Nga auditimi u konstatua se ky bashkimi i operatorëve ekonomikë fitues, sipas Marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë me nr. 4935, nr. 1753, datë 28.08.2017 dhe kontratës së bashkëpunimit me nr. 865 datë 29.06.2017, e kanë ndarë këtë kontratë shërbimi vetëm në %, respektivisht, operatori “G G” ka marrë përsipër të realizojë 20% të vlerës së kësaj kontrate dhe operatori tjetër “A I” do të realizojë 80% të saj. Mirëpo, në kontratën e bashkëpunimit nuk kanë të ndarë dhe të përcaktuar elementët konkretë të realizimit të këtij shërbimi, se çfarë shërbimi apo furnizime konkrete përfaqësojnë këto përqindje për secilin operatorë që do ti realizojë kontratën.

Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII “Kushte të përgjithshme për zbatim”, neni 74 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 2, për pasojë ky bashkim operatorësh duhej të skualifikohej dhe jo të shpallej fitues.

***Sasipër duket qartë se, KVO-ja, ka vepruar me dy standarte, sepse nga njera anë në procedurën (I) e anuluar me të drejtë ka skualifikuar bashkimin e OE, “L” shpk & D M & F M, pasi sipas Kontratës së bashkëpunimit nr. 865 datë 29.06.2017, operatorët ekonomikë, kanë përcaktuar pjesëmarrjen, vetëm në përqindjen e vlerës së shërbimit dhe pa përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të realizonin, ndërsa nga ana tjetër në procedurën me negociim kanë kualifikuar dhe shpallur fitues bashkimin operatorëve ekonomikë “G G”shpk & “AI” i cili dhe ky kishte paraqitur Kontratën e bashkëpunimit pa përcaktuar elementët konkretë të shërbimit që do të realizonin, por vetëm vlerën e shërbimit të shprehur në përqindje.***

- Nga auditimi, në lidhje me *monitorimin e Kontratës së Shërbimi* nr.6409, datë 31.08.2017 u vërejt se, nga pikëpamja formale, hartimi i kontratës ka mangësi në “termat e referencës” pasi sipërfaqet që do të trajtohen janë shprehur vetëm në njësi matëse (në Ha) në bazë qarqesh. Ato nuk janë detajuar edhe mbi bazë njësie administrative të ndara sipas fshatrave dhe pse një informacion i tillë administrohet paraprakisht nga MBZHAU, pasi këto të dhëna dërgohen si kërkesa nga Drejtoritë e Bujqësisë Rajonale të Qarqeve, për llogaritjen e fondit limit. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006”për prokurimin publik” neni 23.

-Nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë në zbatim të nenit 4, pika 4-3, nuk janë përcaktuar ambientet për magazinimin nga ana e të “kontraktuarit” të preparatit të PMB që nevojitet jo më vonë se 2 (dy) ditë para fillimit të trajtimit. Kushti i vendosur në kontratë bie ndesh me VKM nr.1188, datë 20.08.2008 i ndryshuar “Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve” në të përcaktohen qartë rregullat për magazinim këtyre produkteve si dhe me pikën 5.3 “Specifikimet teknike”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **14.1. Rekomandimi:**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të nenit 79 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të njoftoj Agjencinë e prokurimit publik për marrjen e masa administrative ndaj anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe anëtarët e KVO, për mosrespektimin e rregullave të prokurimit, të trajtuar më sipër dhe më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit.

**Menjëherë**

**15. Gjetje:** Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje e vaksinës për luftimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit (limpy skin”, me fond limit në vlerën prej 122,759,000 lekë pa tvsh, realizuar në vitin 2017 me fitues operatorin “A” shpk me vlerë fituese prej 122,700,000 lekë pa tvsh, u konstatua se, monitorimi i kontratës Furnizimi nr. 4817, datë 19.06.2017 dhe dokumentimi i pagesave, nuk është bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar. Nuk është ngritur Komisioni i Mbikëqyrjes së kontratës, për të dokumentuar të gjithë aktivitetin e realizimit të procesit të vaksinimit të gjedhëve. AK është bazuar vetëm në faturën tatimore të shitjes të lëshuara nga operatori fitues “A” shpk, për likuidimin financiar në drejtim të operatorit ekonomik fitues. Në dosjen fizike e administruar nga AK (sektori i prokurimeve dhe sektori i financës) nuk ndodhet asnjë relacion përfundimtar mbi shpërndarjen tek përfituesit ( numri fermerëve përfitues nëpër qarqe të ndryshme të vendit, të cilët përfituar nga vaksinimi, kundër sëmundjes së Dermatozës Nodulare (Lumpy Skin Disease.) Po kështu edhe Urdhër shpenzimi nr.260 datë 03.08.2017,për paesën e operatorit fitues “A” nuk është shoqëruar me dokumentacionit justifikues ligjor dhe financiar, të marrjes në dorëzim të vaksinës nga Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, si dhe nuk figurojnë listat emrore të blektorëve përfitues. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me pikat 35/ b dhe 36 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **15.1. Rekomandimi:**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ngrihet grup pune për të kryer inspektimin e dokumentacionit vërtetues ligjor dhe financiar, pranë Drejtorive të Bujqësisë në qarqet përfituese për vaksinën për luftimin e sëmundjes së dermatozës nodulare të gjedhit (limpy skin), me qëllim që të bëhet e mundur pasqyrimi me transparencë, efektivitet, efencë dhe ekonomikitet të fondeve publike të shpenzuar në këtë procedurë prokuruese.

**Menjëherë**

**16.Gjetje:** Nga auditimi në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Shërbime dhe pjesë këmbimi për sistemin ngrohje-ftohje të MBZHR, viti 2018", u konstatua se, Njësia e prokurimit ka vendosur disa kriteret kualifikuese, të cilat nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në kriterin kualifikues pika 2.3.3 për kapaciteti teknike/ Licenca Profesionale e shoqërisë, është kërkuar që operatori ekonomik të jetë i pajisur me kategorinë NP-12A "Punime të inxhinierisë së mjedisit" dhe në pikën 2.3.4, është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar në stafin e tij Ing. Mjedisi. Nga auditimi i preventivit të shërbimit, konstatohet se kontrata nuk ka elementë të cilët lidhen me inxhinierinë e mjedisit. Rrjedhimisht kërkesat kualifikuese nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit dhe nuk kanë stimuluar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 48-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### **16.1. Rekomandimi:**

Nga Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të merren masa që në të ardhmen, në programimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe punë të hartohen kërkesa për kualifikim që sigurojnë konkurrencën e nevojshme të prokurimit për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin me efikasitet të përdorimit të fondeve publike.

**Në vijimësi**

### **D. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

#### **Gjetje e konstatime me dëm ekonomik në vlerën 69,998,219 lekë.**

**1. Gjetja:** Nga auditimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar e cila sipas rregullores së brendshme të Ministrisë, në përshkrimin e funksioneve të saj, kontabilizon të ardhurat nga pagesa e qirasë vjetore/mujore dhe penalitetet për vonesat për dhënien e tokave me qira, nxjerr detyrimet e qiradhënësve dhe i pasqyron ato në pasqyrat financiare të MBZHR duke respektuar tarifën për ha e përcaktuara për qiranë e tokave bujqësore, plotëson/dërgon faturën për arkëtim si dhe nga auditimi dokumentacionit financiar dhe database të ndërtuar në funksion të arkëtimit të të ardhurave nga qiradhënia e tokave, konstatohen debitorë në arkëtimin e qerave vjetore në vlerën në total 69,998,219 lekë me TVSH (për vitin 2017 në vlerën 31,702,258 lekë, dhe për vitin 2018 në vlerën 38,295,961 lekë) bashkëlidhur aneksi nr. 1 dhe aneksi nr.2 sipas subjekteve për çdo vit respektivisht në detyrim total dhe të mbetur për tu arkëtuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 74-84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurës administrative" të ndryshuar, pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MBZHR të nxirren aktet administrative për të kërkuar arkëtimin e vlerave të qerave, nga debitorët në vlerën në total 69,998,219 lekë me TVSH (për vitin 2017 në vlerën 31,702,258 lekë, dhe për vitin 2018 në vlerën 38,295,961 lekë), sipas nenit 640 të Kodit Civil, si dhe në bazë të Kontratës së dhënies me qera të tokës bujqësore për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësi, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Nga titullari i MBZHR të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin, në vlerën totale 69,998,219 lekë me TVSH vlerë e pa arkëtuar nga qeratë vjetore, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale nga qiramarrësit duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi. (aneksi nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur)

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrit të MBZHR:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

### **Audituesit Shtetërorë të KLSH:**

1. Mariola **LLANAJ**
2. Valentina **GOLEMI**
3. Joniada **GOCAJ**
4. Aldo **KUME**
5. Alkida **LLAKAJ**

**Drejtori**  
Bashkim **ARIZAJ**

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**